

Shtojca 1

PJESA A - Informacioni për sigurinë e produkteve kozmetike

1. Përbërja sasiore dhe cilësore e produktit kozmetik

Përbërja cilësore dhe sasiore e produktit kozmetik, duke përfshirë edhe identitetin kimik të substancave (duke përfshirë kur është e mundur emrin e kimikatit, INCI, CAS, EINECS/ELINCS) dhe funksionin e tyre të synuar. Në rastin e parfumit dhe përbërjeve aromatike, përshkrimin e emrit dhe kodin e përbërjes, si dhe identitetin e furnitorit.

2. Karakteristikat fizike/kimike dhe qëndrueshmëria e produktit kozmetik

Karakteristikat fizike dhe kimike të substancave ose përzierjeve, si dhe të produkteve kozmetike.

Qëndrueshmëria e produktit kozmetik në kushtet e magazinimit të parashikuara në mënyrë të arsyeshme.

3. Cilësia mikrobiologjike

Specifikimet mikrobiologjike të substancës ose përzierjes dhe produkti kozmetik. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë produkteve kozmetike të përdorura rreth syve, në membranën e mukozës në përgjithësi, në lëkurën e dëmtuar, tek fëmijët nën moshën tre vjeç, tek të moshuarit dhe tek personat me imunitet të dobët.

Rezultatet e testit të sfidës së konservimit.

4. Papastërtitë, gjurmët, informacioni për materialin e paketimit

Pastërtia e substancave dhe përzierjet.

Në rastin e gjurmëve të substancave të ndaluara, dëshmi për pashmangshmërinë e tyre teknike.

Karakteristikat përkatëse të materialeve të paketimit, në veçanti pastërtitë dhe qëndrueshmëria.

5. Përdorimi normal dhe i parashikuar në mënyrë të arsyeshme

Përdorimi normal i produktit dhe i parashikuar në mënyrë të arsyeshme. Arsyetimi justifikohet veçanërisht sipas paralajmërimeve dhe shpjegimeve të tjera në etiketimin e produktit.

6. Ekspozimi ndaj produktit kozmetik

Të dhënat për ekspozimin ndaj produkt kozmetik duke marrë parasysh gjetjet sipas seksionit 5, në lidhje me

1) Vendin/vendet e aplikimit;

